



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 400/05-6244
Dt: 16.03.2021

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 pika dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 13 i Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, Marrëveshjes se Mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe OJQ “Shtëpia e Sigurt” për mbështetje financiare të kësaj OJQ-je, me datë 16.03.2021 e mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ-së “Shtëpia e Sigurt” për mbështetje financiare 01-400/04-4823 e datës 04.03.2021, për mbulimin e shpenzimeve lidhur me zhvillimin aktiviteteve të kësaj OJQ-je, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione në vlerë prej 4.000,00€ nga linja e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit, sipas Marrëveshjes se Mirëkuptimit 01 nr.413/01-14313 e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe OJQ “Shtëpia e Sigurt”.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në bazë Marrëveshjes së Mirëkuptimit 01 nr.413/01-14313 e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe OJQ “Shtëpia e Sigurt, të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 4.000,00€, nga linja e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e OJQ “Shtëpia e Sigurt” XK051140096956000158 në Procredit Bank.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- OJQ-së “Shtëpia e Sigurt”
- Arkivit

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini

